



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 158

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 13 shtator 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 674, datë 6.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës..... 19107
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 675, datë 6.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë..... 19108
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 676, datë 6.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë..... 19110
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 702, datë 12.9.2024	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kushteve shtesë për njohjen e organizatave të menaxhimit të peshkimit”..... 19111
Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 7, datë 9.9.2024	Për miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre..... 19114
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)..... 19116



URDHËR
Nr. 674, datë 6.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ZVICRËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidëve.

Nga shteti i Zvicrës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Vaud	Pays-d'Enhaut	Saint-Légier-la-Chiésaz*
Jura	Porrentruy	Buix*
Solothurn	Dorneck	Metzerlen-Mariastein*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën

28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14. deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar, se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14. deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6. dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore.



d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrukat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9. dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9. ose neni 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 675, datë 6.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;

b) materialit biologjik dhe të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;

c) mishin e freskët;

d) produktet e mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70° C për 30 minuta;

e) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;

f) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

g) ushqim me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuara termikisht, ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.

Sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme të shtetit të Turqisë:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Sivas	Ulaş*	
Sivas	Akıncılar*	
Sivas	Yıldızeli*	
Sivas	Altınyayla*	



Sivas	Kangal*	
Sivas	Doğanşar*	
Sivas	Gürün*	
Sivas	Merkez*	
Sivas	İmranlı*	
Diyarbakir	Merkez*	
Konya	Kadınhanı*	
Konya	Ereğli*	
Tunceli	Pülümür*	
Tunceli	Pertek*	
Denizli	Çal*	
Denizli	Çivril*	
Erzurum	Şenkaya*	
Erzurum	Çat*	
Erzurum	Uzundere*	
Erzurum	Hınıs*	
Erzurum	Karaçoban*	
Erzurum	Aşkale*	
Erzurum	Tekman*	
Erzurum	İlica*	
Erzurum	İspir*	
Afyon	Sandıklı*	
Afyon	Dinar*	
Afyon	Bolvadin*	
Afyon	Sincanlı*	
Afyon	Sultandağı*	
Afyon	Merkez*	
Afyon	İhsaniye*	
Batman	Kozluk*	
Isparta	Yalvaç*	
Isparta	Keçiborlu*	
Isparta	Gönen*	
Isparta	Merkez*	
Isparta	Şarkıkaraağaç*	
Izmir	Seferihisar*	
Izmir	Bayındır*	
Aydın	Germencik*	
Aydın	İncirliova*	
K. Maras	Elbistan*	
Burdur	Merkez*	
Burdur	Karamanlı*	
Burdur	Bucak*	
Aksaray	Eskil*	
Aksaray	Güzelyurt*	
Aksaray	Gülağaç*	
Aksaray	Merkez*	
Adana	Tufanbeyli*	
Adana	Karataş*	
Adana	Aladağ*	
Trabzon	Maçka*	
Rize	İkizdere*	
Kütahya	Simav*	

Kütahya	Aslanapa*	
Kütahya	Emet*	
Konya	İlgin*	
Konya	Altınekin*	
Konya	Tuzlukçu*	
Konya	Derbent*	
Kırşehir	Akpınar*	
Kırşehir	Akçakent*	
Kırşehir	Merkez*	
Kayseri	Sarıoğlu*	
Kayseri	Yahyalı*	
Kayseri	Akkışla*	
Kayseri	Pınarbaşı*	
Erzincan	Otlukbeli*	
Erzincan	Üzümlü*	
İğdır	Karakoyunlu*	
Bingöl	Yedisu*	
Erzincan	Çayırlı*	
Erzincan	Tercan*	
Erzincan	Otlukbeli*	
Erzincan	Merkez*	
Nevşehir	Kozaklı*	
Nevşehir	Gülşehir*	
Van	Erciş*	
Mus	Bulanık*	
Mus	Merkez*	
Mus	Varto*	
Malatya	Yazıhan*	
Malatya	Merkez*	
Mardin	Savur*	
Kars	Arpaçay*	
Kars	Merkez*	
Kars	Sankamış*	
Kars	Digor*	
Elazığ	Merkez*	
Elazığ	Karakoçan*	
Elazığ	Alacakaya*	
Elazığ	Kovancılar*	
Adiyaman	Gölbaşı*	
Adiyaman	Gerger*	
Nevşehir	Merkez*	
Eskisehir	İnönü*	
Eskisehir	Sivrihisar*	
Agri	Merkez*	
Agri	Tutak*	
Hakkari	Merkez*	
Siirt	Şirvan*	

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë



Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, mielli i mishit, mielli i gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara dhe ushqimit të kafshëve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.

3. Urdhri nr. 585, datë 29.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 676, datë 6.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
TË DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN
E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja Administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Adana	Kozan*	
Adana	Aladağ*	
Malatya	Arguvan*	
Karaman	Merkez*	
Izmir	Dikili*	
Izmir	Çiğli*	
Izmir	Ödemiş*	
Kars	Kağızman*	
Hakkari	Merkez*	
Aydin	Sultanhisar*	
Çankiri	Çerkeş*	
Ankara	Bala*	
Ankara	Polatlı*	
Ankara	Elmadag*	
Afyon	Sandıklı*	
Aksaray	Merkez*	
Balikesir	Bandırma*	
Balikesir	İvrindi*	
Balikesir	Merkez*	
Bursa	Gemlik*	
Erzurum	Tekman*	
Erzincan	Tercan*	
Isparta	Uluborlu*	
Karabük	Eflani*	
Giresun	Yağlıdere*	
Rize	Çamlıhemşin*	
Tokat	Zile*	
Tokat	Başçiftlik*	
Uşak	Merkez*	
Uşak	Eşme*	
Aydin	Köşk*	
Çorum	Kargı*	
Erzincan	Merkez*	
Eskisehir	Beylikova*	
Eskisehir	Seyitgazi*	
Kütahya	Tavşanlı*	
Bursa	Orhangazi*	
Bursa	Orhaneli*	
Çanakkale	Lapseki*	
Agri	Doğubeyazıt	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë



të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1. Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose të dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditët e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose të dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor, jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2. Për spermën e cjepeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose të dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial, ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe të dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe të dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe të dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen, gjithashtu, në certifikatë).

2.3. Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe të dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga autoriteti veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 559, datë 23.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 702, datë 12.9.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE
SHITESË PËR NJOHJEN E
ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT
TË PESHKIMIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 62, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kushteve shtesë për njohjen e organizatave të menaxhimit të peshkimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE
SHTESË PËR NJOHJEN E ORGANIZATAVE
TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e kushteve shtesë për njohjen e organizatave të menaxhimit të peshkimit.

Neni 2
Zbatimi

Kjo Rregullore aplikohet për organizatat e menaxhimit të peshkimit, të cilat kërkojnë të njihen si të tilla me urdhër të ministrit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “*Ministër*” është ministri që mbulon aktivitetin e peshkimit.

2. “*Ministria*” është ministria që mbulon aktivitetin e peshkimit.

3. “*Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)*” është person juridik privat, e krijuar sipas nenit 26, të Kodit Civil, të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 64/2012, të ndryshuar, me qëllim pjesëmarrjen në bashkëmenaxhimin e burimeve të peshkimit në një zonë të caktuar.

4. “*Plan bashkëmenaxhimi*” është një plan për menaxhimin e zonës së bashkëmenaxhimit të peshkimit, që përgatitet në përputhje me dispozitat e nenit 53, të ligjit nr. 64/2012, të ndryshuar.

5. “*Zonë bashkëmenaxhimi*” është një zonë e peshkimit, e caktuar ligjit nr. 64/2012, të ndryshuar, ku një organizatë merr pjesë në menaxhimin e burimeve të peshkimit.

6. “*Njohja*” është procesi i verifikimit të një OMP-je për të treguar që ajo përmbush kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 64/2012, të ndryshuar, si dhe kushtet shtesë të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 4
Kushte të përgjithshme

1. OMP-të duhet të jenë të regjistruara ligjërisht si persona juridikë në Republikën e Shqipërisë.

2. OMP-të duhet të kenë struktura administrative dhe operacionale të përshtatshme për menaxhimin e resurseve të peshkimit.

3. OMP-të duhet të kenë ekspertizë dhe kapacitete të nevojshme për të zbatuar praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të peshkimit.

Neni 5
Kushtet shtesë për njohjen e Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit

Ministria mund të njohë si OMP çdo grup të krijuar, me qëllim pjesëmarrjen në bashkëmenaxhimin e burimeve të peshkimit në një zonë të caktuar, me kusht që:

a) të respektojë parimet e përmendura në nenin 6 të kësaj Rregulloreje dhe rregullat e miratuara për zbatimin e tyre;

b) të ketë seli qendrore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) të ndjekë objektivat e përcaktuara në nenin 60, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;

ç) të sigurojë informacion të detajuar dhe të përshtatshëm në lidhje me anëtarët, administrimin dhe burimet e financimit;

d) nuk janë marrë sanksione në fushën e peshkimit ndaj anëtarëve themelues të organizatës për tre vjetët paraardhës nga momenti i paraqitjes së kërkesës për njohje.

Neni 6
Funksionimi i brendshëm i Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit

Funksionimi i brendshëm i OMP-së bazohet në parimet e mëposhtme:



a) vendosja e një kontributi financiar për anëtarët për financimin e organizatës;

b) funksionimin demokratik që lejon anëtarët të kontrollojnë organizatën dhe vendimet e saj;

c) zbatimi i sanksioneve efektive, bindëse dhe proporcionale në rast mosrespektimi të detyrimeve të përcaktuara nga Rregulloret e brendshme të organizatës, veçanërisht në rast të mospagesës së kontributeve financiare;

ç) përcaktimi i rregullave që kanë të bëjnë me pranimin e anëtarëve të rinj dhe përjashtimin e anëtarëve ekzistues;

d) përcaktimi i rregullave kontabël dhe buxhetore të nevojshme për menaxhimin e organizatës.

Neni 7

Afati i dorëzimit dhe forma e kërkesës për njohje

1. Ministria, me shpalljen e një zone bashkëmenaxhuese, me vendim të Këshillit të Ministrave, fillon procedurën e njohjes së një OMP-je për këtë zonë bashkëmenaxhuese.

2. Afati për dorëzimin e kërkesave për njohje nga OMP-të është 15 ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës bashkëmenaxhuese.

3. Ministria njofton në faqen e saj zyrtare për paraqitjen e kërkesave për njohje nga OMP-ja, në rastin se në zonën bashkëmenaxhuese në fjalë, nuk ka pasur kërkesa për njohje sipas pikës 2 të këtij neni, këto kërkesa janë refuzuar, ose në rast të revokimit të njohjes, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

4. Afati për dorëzimin e kërkesave, sipas pikës 3 të këtij neni, është 15 ditë nga momenti i shpalljes së njoftimit në faqen zyrtare të Ministrisë.

5. Kërkesat dorëzohen në formë të shkruar dhe përmban informacionet dhe dokumentet e kërkuara, sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Dokumentacioni dhe informacioni i kërkuar

Dokumentet dhe informacioni që paraqiten nga OMP-ja e interesuar për njohje përfshijnë:

a) aktin e regjistrimit të organizatës;

b) statutin e organizatës dhe aktin e themelimit;

c) numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPIT);

ç) planin e menaxhimit të peshkimit, i cili përmban:

i. vizionin për menaxhimin afatgjatë të zonës;

ii. punësimi;

iii. investimet e planifikuara;

iv. të ardhurat;

d) rregullat për funksionimin e brendshëm, sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj Rregulloreje;

dh) emrat e personave që mund të veprojnë në emër dhe për llogari të organizatës;

e) listë e anëtarëve të organizatës së menaxhimit të peshkimit, të përbërë, minimalisht prej 20 peshkatarësh anëtarë.

Neni 9

Procedura e shqyrtimit të kërkesave

Struktura përgjegjëse për peshkimin shqyrton të gjitha kërkesat për njohje, të dorëzuara në Ministri, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit.

1. Në qoftë se kërkesa për njohje nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e nenit 8 të kësaj Rregulloreje, OMP-së i kërkohet që të plotësojë dokumentacionin e munguar ose të japë informacion shtesë, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit.

2. Kur OMP-ja siguron dhënien e dokumentacionit dhe të informacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar, kërkesa quhet e regjistruar nga dita që është dërguar. Kur OMP-ja nuk plotëson mangësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet OMP-së.

3. Pas shqyrtimit, struktura përgatit një raport dhe rekomandimet për njohjen ose refuzimin e kërkesave.

4. Ministri vendos për njohjen e OMP-së brenda një afati prej 3 muajsh pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga përfaqësuesi i organizatës përkatëse dhe pas verifikimit për plotësimin e kushteve të përcaktuara nga ky ligj.

5. Urdhri i njohjes i dërgohet OMP-së dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë.

Neni 10

Kontrollet dhe tërheqja e njohjes

1. Pas njohjes, Ministria mund të kryejë kontrolle të rregullta, periodike, për të verifikuar respektimin nga ana e organizatës të kushteve të njohjes të



përcaktuara në këtë Rregullore, si dhe në ligjin nr. 64/2012, të ndryshuar.

2. Ministria mund të tërheqë ose të revokojë njohjen e organizatës:

a) nëse pas kontrollit të aktivitetit të saj dhe lënies së rekomandimeve përkatëse, konstaton mosrespektimin e përsëritur të kushteve të njohjes;

b) në rastet kur kjo njohje është realizuar mbi tregues të gabuar.

c) në rast ndryshimi të politikave të menaxhimit dhe të shfrytëzimit të zonës bashkëmenaxhuese.

3. Ministria njofton organizatën për tërheqjen e njohjes, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 11
Ankimi

Kundër vendimmarrjes të ministrit për tërheqjen ose refuzimin e njohjes së një OMP-je, organizata ka të drejtë të bëjë ankim brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi shqyrtohet nga Ministria brenda 30 ditësh, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

VENDIM
Nr. 7, datë 9.9.2024

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË
KUTIVE DHE TË DOSJEVE PËR
RUAJTJE TË PËRHERSHME, PËR
ARKIVAT JO NË VEPRIM, SI DHE PËR
INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË
DOKUMENTE TË TIPOLOGJISË, OSE
QË RUAJNË DOKUMENTACION
GJITHNJË PRANË TYRE**

Mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 14, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; në nenin 4/1, si dhe në shkronjat “ë” dhe “p”, të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive dhe të dosjeve për ruajtje të përhershme, për arkivat jo në veprim, si dhe për institucionet që administrojnë dokumente të tipologjisë, ose që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së institucioneve që administrojnë dokumente të tipologjisë, që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për sqarime teknike.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

6. Vendimi nr. 1, datë 18.1.2023, “Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I ARKIVAVE
Ardit Bido



SHTOJCA 1

STANDARDET E KUTIVE DHE TË DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME, PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM, SI DHE PËR INSTITUCIONET QË ADMINISTROJNË DOKUMENTE TË TIPOLOGJISË, OSE QË RUAJNË DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	Kutia: - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë së paku 615 g/m ² që të lejojë valëzueshmërinë, duke mos cenuar përmasat e kutisë. - Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin. - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	Dosja: - Kartoni të jetë së paku me gramaturë 325 gr/m ² , duke mos cenuar përmasat e dosjes, me 2 krahë të brendashkruar të palosur, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	
Dosje për ruajtje të përhershme	36x24	

Bashkëngjitur skicat me përmasat e kutive dhe të dosjeve me ruajtje të përhershme.

SHTOJCA 2

LISTA E INSTITUCIONEVE QË
ADMINISTROJNË DOKUMENTE TË
TIPOLOGJISË, QË JANË TË DETYRUARA
TË ZBATOJNË STANDARDIN E KUTIVE
DHE TË DOSJEVE PËR RUAJTJE TË
PËRHERSHME

1. Arkivat shtetërorë të përhershëm dhe qendror në veprim.

2. Institucionet shtetërore qendrore e të varësisë që administrojnë dokumente të tipologjisë, si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (regjistra të gjendjes civile; regjistra të lindjes dhe vdekjes; regjistra për martesat dhe zgjidhje të martesave etj.).

b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (kartoteka).

c) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (dosjet me dokumentacion tërësor, për patentat, licencat, mbrojtjen e së drejtës së autorit që ruhen mbi 50 vjet).

d) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (Dosjet e lejeve të drejtimit,

qarkullimit dhe mjeteve të transportit, që ruhen mbi 50 vjet, regjistra, etj.).

e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (regjistra të subjekteve tatim-pagues që ruhen mbi 50 vjet).

f) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (librat e pagave, bordero etj.).

g) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (dokumente për regjistrimin, shqyrtimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme që ruhen mbi 50 vjet, regjistra etj.).

h) Spitalet universitare dhe rajonale (kartelat shëndetësore që ruhen mbi 50 vjet).

i) Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Parauniversitar (regjistrat e amzave, librat e indeksëve etj.).

j) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (për marrëveshjet ndërkombëtare).

3. Institucionet e tjera, që ruajnë e administrojnë dokumente tipologjike mbi 50 vjet, i kërkojnë Këshillit të Lartë të Arkivave, përfshirjen në këtë vendim.

**VENDIM****Nr. 1816, datë 10.9.2024****BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR NË AUTORITETIN
KOMBËTAR PËR SIGURINË E
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
(AKSIK)**

Bazuar në ligjin nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”, VKM-ja nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017, “Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) në AKSIK, ka deklasifikuar Raportet e Grupit të Punës (GP), informacione të klasifikuara “Sekret shtetëror”, të nivelit “Sekret”, si më poshtë:

a) Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i (GP) nr. 11881, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Aurel Ajet Celibashi”.

2. Raport i (GP) nr. 11824, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Bezart Besim Kaçkini”.

3. Raport i GP-së nr. 11616, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Gerti Trifon Shani”.

4. Raport i GP-së nr. 12367, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Dashnor Et’hem Nure”.

5. Raport i GP-së nr. 12048, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Saimir Shpëtim Nazifi (Hafuzi)”.

6. Raportet e GP nr. 12477, datë 2.11.2017 me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Seladin Zini Pysqyli”.

7. Raport i GP-së nr. 12264, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Anida Pjetër Bica”.

8. Raport i GP-së nr. 11669, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Z. Spartak Gaqi Mitrushi”.

9. Raport i GP-së nr. 12006, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Majlinda Petrit Miska (Moshë)”.

10. Raport i GP-së nr. 12042, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Nertila Besim Ndregjoni”.

11. Raport i GP-së nr. 11800, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Ariana Xhevair Gaçi”.

12. Raport i GP-së nr. 11866, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Kaliona Grigor Nushi”.

13. Raport i GP-së nr. 11753, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Roland Lulzim Agolli”.

14. Raport i GP-së nr. 12066, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Gëzim Qerim Veizi”.

15. Raport i GP-së nr. 11667, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Aurel Trifon Zarka”.

16. Raport i GP-së nr. 11563, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Alma Selami Troshani”.

17. Raport i GP-së nr. 12378, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Eranda Koço Laze (Felaj)”.

18. Raport i GP-së nr. 2636, datë 24.5.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Seladin Zini Pysqyli”.

19. Raport i GP-së nr. 11792, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Jurgen Xhavit Selimi”.

20. Raport i GP-së nr. 11617, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Besmir Bexhet Rrapaj”.

21. Raport i GP-së nr. 12467, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Besnik Yldi Maho”.

22. Raport i GP-së nr. 12064, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së



subjektit të rivlerësimit znj. Monika Gaço Çuhadari”.

b) Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP-së nr. 241, datë 22.1.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Artan Ukë Hajredinaj”.

2. Raport i GP-së nr. 563, datë 7.2.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. Fatime Syrja Deçolli”.

3. Raport i (GP) nr. 1702, datë 29.3.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Petref Demir Asllani”.

4. Raport i GP-së nr. 2141, datë 25.4.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Zj. Idush Riza Maliqi”.

5. Raport i GP-së nr. 1704, datë 2.4.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Zj. Sonjela Hysen Voskopi”.

6. Raport i GP-së nr. 12039, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Zj. Aulona Malo Bodo”.

7. Raport i GP-së nr. 3380, datë 2.7.2024, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Dashnor Et’hem Nure”.

c) Publikimi i bibliografisë të bëhet në Fletoren Zyrtare dhe në web-in e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Altin Jani

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 64 lekë